VENDIM
Nr.150, datë 18.3.2005

PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË SË PAKETËS SË AKSIONEVE TË KAPITALIT TË "ARMO" SHA-SË, QË U OFROHET PËR SHITJE INVESTITORËVE STRATEGJIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të "Armo" sh.a., Fier", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përqindja e aksioneve të kapitalit të "Armo" sh.a.-së, që u ofrohet për shitje investitorëve strategjikë të jetë 76 për qind.
2. Investitori strategjik ka të drejtë të marrë pjesë në transferimin e paketës së mbetur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano